



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË

Nr. 4120/118 Prot.

Divjakë, më 22.05.2025.

PROJEKT – VENDIM

NR. 32 DATË 22.05.2025

PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË NDIHMËS FINANCIARE Z. ORDINAND VELIAJ, PËR REHABILITIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA RËNIA E ZJARRIT NË BANESË, QYTETI DIVJAKË, NJËSIA ADMINISTRATIVE DIVJAKË, BASHKIA DIVJAKË

Mbeshtetur ne ligjin Nr. 139/2015 , date 17.12.2015 “ *Per Veteqeverisjen Vendore* ”, neni 3, shkronja “e” , neni 40, pika 1, VKM Nr. 414 datë 08/07/2021, pika 3.1, shkronja “a”, pika 5, pika 6, Ligjit Nr.45/2019 “Për Emergjencat Civile”, Neni 7, Neni 30 germa “ gj”, VKM Nr. 329 datë 16/05/2012, Paragrafi III, gërma “e” , gërma “ë” dhe “f”, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” sipas kërkesës së z.Ordinand Veliaj i propozojme Keshillit te Bashkise Divjake, me date 27.05.2025:

- 1- Të miratojë kërkesën e Bashkisë Divjakë, për mbështetje financiare të shtetasit **z. Ordinand Veliaj**, për dëmtimin nga zjarri te katit të pare të banesës së tij.
- 2- T’i akordojë familjes së shtetasit z. Ordinand Veliaj, ndihmën financiare prej 50% te vleres se perllogaritur, nga vlere e cila $622\ 624 : 2 = 311\ 312$ **lekë prej (Treqind e njëmbëdhjetë mijë e treqind e dymbëdhjetë)lekë** nga fondi rezerve pjese e buxhetit te vitit 2025 te miratuar nga Këshilli i Bashkisë Divjake.
- 3- Kjo ngjarje klasifikohet si emergjence civile dhe si e tille ka qene e pa mundur te parashikohet si ze specifikisht ne Buxhet.
- 4- Burimi i financimit per kete ndihme do te jete nga Buxheti 2025, grupi 00, programi 04910 kapitulli 05/01, llogaria 604, nga e cila kapitulli 01 mbulon 80% te vleres, dhe kapitulli 05 mbulon 20% te vleres.

Specializr Agronom dhe Emergjencave Civile
Ferit Qosja

Juristi
Andi Bullari

Drejtoria e Finances dhe Buxhetit
Xheladin Brahkola

KRYETARI
JOSIF GORREA